



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA- VLADA- GOVERNMENT  
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite / Ministry of Labour and Social Welfare  
Sektor i Arkivës-Sektor Archive-Archive Sector

Ajësia Org. \_\_\_\_\_ Nr. Prot. 3202  
Breg. Jordiniga \_\_\_\_\_ Broj Prot. \_\_\_\_\_  
Breg. Unit \_\_\_\_\_ Prot. NO: \_\_\_\_\_  
Breg. Llogjeve \_\_\_\_\_ Data: 10.08.19  
Breg. Stranica \_\_\_\_\_ Datum: \_\_\_\_\_  
Breg. Pagine \_\_\_\_\_ Date: \_\_\_\_\_  
Prishtine-Prishtina-Prishtina

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

## KONTRATA

**TITULLI I KONTRATËS: Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

Nr. i Prokurimit <sup>1</sup>	209-19-5905-5-3-6
Nr i brendshëm	209/19/029/536

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Numri i Prokurimit: **209-19-5905-5-3-6** Nr i brendshëm

– Titulli **Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

## **PJESA B: KONTRATA**

**MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

**"4ING" SH.P.K., p.n., -, PAKASHTICË E POSHTEME** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

**Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë** me numër Identifikues **209-19-5905-5-3-6** Nr i brendshëm **209/19/029/536**

### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **3** ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe përfundon pas **30** ditë.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **30** ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë **Inspektoriat i Punës Prishtinë dhe Inspektoriat i Punës në Pejë**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>2</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

---

<sup>2</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

– Titulli **Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4878,25 €.**; [katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë euro, njëzetë e pesë cent] Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

**Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

**Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve. **Pas përfundimit të punëve do të dorëzohet garancioni i defekteve në afat prej 12 muajve.**



– Titulli **Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

**Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

**Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Menaxheri i Projektit është

**Kompania mbikqyrëse “Eng Idea” dhe “Sib Bka”**

**Sipas nenit 81 të LPP aktual në fuqi, Menagjimin e Kontratës nga ana e MPMS: Luan Kastrati,**

**Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

**Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

– Titulli **Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *[specifiko gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin e Kosovës.

**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues	
<b>Emri:</b>	Shpejtim Kajtazi	<b>Emri:</b>	Feti Ibishi
<b>Pozita:</b>	Drejtor	<b>Pozita:</b>	Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	10.09.2019	<b>Data:</b>	10.09.2019
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

– Titulli **Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

## **Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të objektit të kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar të vendosë specifikime teknik që favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

1. **Të respektohen të gjitha normat, standardet teknike ndërtimore**
2. **Të respektohet plotësisht Ligji i Ndërtimit**
3. **Të zbatohet përshkrimi teknik, gjegjësisht projekti**



Numri i Prokurimit: 209-19-5905-5-3-6 Nr i brendshëm


– Titulli **Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

## Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht seksionin III.1 të Informacionit për Tenderuesit, dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	4ING SH.P.K.
Adresa e plotë:	PAKASHTICE E POSHTME -PODUJEVE
Përfaqësuar nga:	
Emri	SHPETIM KAJTAZI
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi	
Data	26.08.2019
Vula	



Prokurimi: 209-19-5905-5-3-6

Nr i brendshëm: 209/19/029/536

**Tituli: Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

1 **Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

Kodi i tenderit: 26.08/2019

Data: 25.08.2019

**Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse**

---

Nr.	Dokument
1.	1.Deklarata nen Betim.zip
2.	2.Vertetimi i ATK.zip
3.	3.Vertetimi i Gjykates Ekonomike.zip
4.	4.Certifikata e biz,Nr.fis&TVSH.zip
5.	5.Kapaciteti Financiar.zip
6.	6.LISTA E KONTRATAVE.zip
7.	7.REFERENCAT DHE RAPORTET E PRANIMIT TEKNIK.zip
8.	8.Projekt menaxheri-Arkitekti.zip
9.	9.Lista e Mjeteve te Punes.zip
10.	10.Plani Dinamik.zip

**Përshkrimi i çmimeve**

---

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë	Pershkrimi i cmimev MPS.zip

**Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:**

---

- 1.Deklarata nen Betim
- 2.Vertetimi i ATK-se
- 3.Certifikata e Gj.Ekonomike
- 4.Certifikata e Biz&Nr.Fis
- 5.Kapaciteti financiar
6. Lista e kontratave
7. Referecat
8. Inxhinieri i arkitektures
- 9.Lista e mjeteve te punes
10. Plani dinamik



## **AUTORITETI KONTRAKTUES**

---

**MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE, Mis Edit Durham Nr.46, 10000, PRISHTINË,**

**Zyrtari përgjegjes i prokurimit:**

**Nr i Prokurimit: 209-19-5905-5-3-6**

### **OPERATOR EKONOMIK:**

---

**Emri i kompanisë dhe adresa e plote: " 4ING " SH.P.K., p.n., -, PAKASHTICË E POSHTEME, Kosovë**

**E-mail: 4ing16@gmail.com**

**Personi kontaktues: SHPETIM KAJTAZI**

**Telefoni: 049 114 860**

**049 359 065**

**Faxi:**

**Numri fiskal: 601587811**

**Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):**

## FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

### Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 209-19-5905-5-3-6

Titulli i kontratës: **Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

#### **1 Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

3. Çmimi total i tenderit është:

**4.878,25 EUR**

Dhe në fjalë *[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]*

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 30 nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK
8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

nesh nëse e bën këtë.

**Informacion në lidhje me nënkontraktorët**

Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)






Numri i Prokurimit: 209-19-5905-5-3-6 Nr i brendshëm

– Titulli **Renovimi i Zyreve të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë dhe në Pejë**

## Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

PJESA	PËRSHKRIMI	TOTALI - €
	<b>RENOVIMI I ZYREVE TË INSPEKTORIATIT TË PUNËS NË PRISHTINË DHE NË PEJË</b>	<b>4878.25</b>
<b>Totali i përgjithshëm:</b>		<b>4878.25</b>

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	4ING SHPK
ADRESA E PLOTE	PAKASHTICE E POSHTME-PODUJEVE
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	SHPETIM KAJTAZI
POZITA	DREJTOR
NENSHKRIMI	
DATA	26.08.2019
VULA	



## PARAMASA DHE PARALLOGARIA

<b>AIP-Prishtinë</b>					
I	Nr. Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
	<b>Mobilizimi</b>				
	1.1 Mobilizimi i kompanisë dhe konzervimi - ruajtja e paisjeve të cilat nuk do të hiqen. Ruajtja dhe rikthehimi për ato paisje që duhet të rivendosen në vendin që e përcakton Investitori/organi mbikqyres	komplet	1	100.00 €	100.00 €
					<b>100.00 €</b>
Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
	<b>2 Perpunimi Final I Mureve ne Brendi</b>				
2.1	Demolimi i suvasë së demtuar përfshi, pastrimin, largimin e materialit deri në deponi administrative.	m2	20	2.00 €	40.00 €
2.2	Pastrimi dhe gryerja e sipërfaqeve të murit ekzistues, nga mbetjetet dhe papasterlinat sipërfaqësore.	m2	1245	0.25 €	311.25 €
2.3	Suvatimet e parapara duke përdorur rrjetimet (një ose më shumë shtresa me ngjitës) për lidhjen e materialeve me ankorime metalike si masa paraprake para suvatimeve finale me llaç të parapërgatitur "MP75" apo ngjashëm (t=10mm(max.)). Suvatimi në vete përmban edhe kompletimin me këndore metalike dhe pajisje tjera përcjellëse për formime të kërkuara gjeometrike. Para suvatimeve finale, në zonat me deformime të theksuara sipërfaqësore bëhet para-suvatimi me llaç natyral (rëre : çimento: gëlqere = 6 : 3 : 0.5) si masë nivelizuese për t'iu shmangur trashësive të mëdha me suvatim të parafabrikuar, natyrisht me përdorim paraprak dhe pas lyerjeve me bazën ground (ngjitës) për lidhje dhe rrjetime përforcuese. Në cmim të përfshihen edhe këndoret rreth dyerve dhe dritareve.	m2	30	4.00 €	120.00 €
2.4	Patënimi i sipërfaqësore mbi muret e suvatuara, sipërfaqet me suvatim nga llaçi me bazë çimentoje dhe baze gipsi. Përdoren materiale të familjes së llaçrave "gletofix" apo të ngjashme duke para-përdorur lyerjet për ngjitje të shtresave njëra mbi tjetrën, përfshirë dhe aksesorët për formime të rregullta gjeometrike. Llogaritja e punimeve të realizuara në "m2" neto sipërfaqe të realizuar. Në cmim të përfshihet sanimi i demtimeve në mure.	m2	350	3.00 €	1,050.00 €
2.5	Sjellja e materialit dhe ngjyrosja e mureve me ngjyrë plastike (anti-bacterial).	m2	1245	0.94 €	1,170.30 €
					<b>2,691.55 €</b>
Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
	<b>3 Punët e Muratimit</b>				
3.1	Furnizimi me material si dhe punimi i mureve të brendshme ndarese nga pllakat e gipsit me trashësi të pllakes së gipsit 12mm', veshja e murit bëhet nga të dy anet me pllaka gipsi . Në cmim të llogariten edhe elementet konstruktive për realizimin e mureve nga pllakat e gipsit.	m2	7.1	16.00 €	113.60 €
					<b>113.60 €</b>
Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
5	<b>Punët e zdrukthtarisë</b>				



5.1	Parafabrikimi, transporti dhe montimi i deres nga materiali PVC , me trashesi te profilit 80 mm, gjeresi min 60 mm, me dimensione b/h = 90/205 cm sipas vizatimit. Ngjyra te perzgjidhet nga Investitori / Organi Mbikqyres	copë	1	145.00 €	145.00 €
-----	---	------	---	----------	----------

**145.00 €**

Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
6	<b>Punët e elektrikes</b>				
6	Furnizimi, transporti dhe meremetimi I trupave ndriçues flouriscent 4x18W, me RASTER, ballast (VVG), kompensim, komplet me gypa, fluoreshent Lumilux 18 W / 840, prodhim "Intra Lighting" apo ngjashëm. Ketu perfshihet ndërrimi I gypave fluoreshent, starterav dhe trafove.				
	Furnizimi, transporti dhe montimi I gypave floruscent 18W	copë	24	4.00 €	96.00 €
	Furnizimi, transporti dhe montimi I strterave 20 W	copë	24	4.00 €	96.00 €
	Furnizimi, transporti dhe montimi I trafove per trupa ndriçues floruscent 4x18W	copë	10	5.00 €	50.00 €
					<b>242.00 €</b>

### Rekapitulim AIP- Prishtinë

1	Mobilizimi				100.00 €
2	Perpunimi Final I Mureve ne Brendi				2,691.55 €
3	Punët e Muratimit				113.60 €
4	Punët e zdrukthtarise				145.00 €
5	Punët e elektrikes				242.00 €
				<b>TOTAL I:</b>	<b>3,292.15 €</b>

### AIP-Pejë

Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
1	<b>Mobilizimi</b>				
1.1	Mobilizimi I kompanisë dhe konzervimi - ruajtja e paisjeve të cilat nuk do te hiqen. Te ruhen dhe te kthehen prap ato paisje qe duhet te kthehen ne vendin qe e percakton Investitori/organi mbikqyres	komplet	1	100 €	100 €
					<b>100 €</b>
Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
2	<b>Punët e Demolimit</b>				
2.1	Demolimi i tepisonit dhe parketit ekzistues. Ne cmim te perfshihet heqja dhe transporti i materialit deri ne deponi te cilen e cakton Investitori/Organi Mbikqyres.	m2	50	1.5 €	75 €
					<b>75.00 €</b>
Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
3	<b>Perpunimi Final I Mureve ne Brendi</b>				
3.1	Pastrimi dhe grryerja e siperfaqeve te murit ekzistues, nga mbetjetet dhe papastertinat siperfaqesore.	m2	338	0.30 €	101 €
3.2	Patenimi i sipërfaqësore mbi muret e suvatuara, sipërfaqet me suvatim nga llaçi me bazë çimentoje dhe baze gipsi. Përdoren materiale të familjes së llaçrave "gletofix" apo të ngjashme duke para-përdorur lyerjet për ngjitje të shtresave njëra mbi tjetrën, përfshirë dhe aksesorët për formime të rregullta gjeometrike. Llogaritja e punimeve të realizuara në "m2" neto sipërfaqe të realizuar. Ne cmim te perfshihet sanimi I demtimeve ne mure.	m2	70	2.80 €	196 €

3.2	Sjellja e materialit dhe ngjyrosja e mureve me ngjyrë plastike (anti-bacterial).	m2	338	1.15 €	389 €
					<b>686.10 €</b>

Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
4	<b>Punet e dyshemes</b>				
4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi I pllakave te qeramikes ne dysheme, lloji dhe ngjyra caktohet nga investitori/ organi mbikqyrsi, te kualitetit te pare. , si dhe furnizimi, transporti dhe vendosja e fuges dhe cokulles 7cm te parashihen ne cmim.	m2	50	14.50 €	725.00 €
					<b>725.00 €</b>

**Rekapitullim AIP - Pejë**

1	Mobilizimi				100.00 €
2	Punët e Demolimit				75.00 €
3	Perpunimi Final I Mureve ne Brendi				686.10 €
4	Punet e dyshemes				725.00 €
				<b>TOTAL II:</b>	<b>1,586.10 €</b>

**RIKAPITULLIM**

I	Rekapitullim AIP- Prishtinë	3,292.15 €
II	Rekapitullim AIP - Pejë	1,586.10 €
<b>TOTAL:</b>		<b>4,878.25 €</b>

VËREJTJE: TË GIJTHA PRODHIMET KU JANË PËRMENDUR EMRAT E PRODHUESVE MUND TË SIGUROHEN PRODHIME TË NGAJSHME ME KARAKTERISTIKA TË NJËJTA OSE MË TË MIRA

KONTROLLOJENI FORMULËN QË TË PËRFSHIHEN TË GIJTHA POZICIONET, AUTORITETI KONTRAKTUES NUK MBAN PËRGJEGJËSI PËR GABIMET EVENTUALE NË FORMULË.

